



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR



PROCESVERBAL

**MBLEDHJA E KOMISIONIT TË VLERËSIMIT TË APLIKIMEVE
(KVA) PËR GBP 2025**

17 tetor 2025

Hapja e mbledhjes

Z. Sonil Frashëri, Këshilltar/MSHPV në cilësinë e Kryetarit të Vlerësimit të Aplikimeve hapi mbledhjen e dytë të Komisionit të Vlerësimit për Grantin e Bazuar në Performancë. Në fjalën e tij hyrëse, ai falenderoi pjesëmarrësit për angazhimin e tyre dhe prezantoi përbërjen e komisionit si dhe pjesëmarrësit e pranishëm në këtë sesion. Më pas, ai paraqiti një përmbledhje të rezultateve paraprake të procesit të vlerësimit për treguesin që lidhet me **Planin Vendor Integritetit**.

Në vijim të sesionit, *znj. Olta Caca – Drejtor i Statistikës dhe Performancës – Sekretariati Teknik*, paraqiti në mënyrë të strukturuar procedurën administrative që ndiqet sipas Udhëzimit të Përbashkët nr.01, datë 11.07.2025, për shqyrtimin e aplikimeve të dorëzuara nga bashkitë. Ajo theksoi gjithashtu rolin dhe përgjegjësitë e sekretariatit teknik në këtë proces.

Më tej, *znj. Elda Hysa – Specialist i Statistikës- Sekretariati Teknik*, bëri një shpjegim të detajuar të të gjithë kriterëve që duhen përbushur për Planin Vendor të Integritetit dhe vijoi me paraqitjen e rezultateve paraprake të verifikimeve mbi dokumentacionin e dorëzuar nga bashkitë. Më tej vuri në dukje se KVA duhet të vlerësojë më specifikisht rastin e bashkisë Pukë, e cila ka aplikuar me dokumentacion për shtyerjen e afatit të planit të hartuar 2022-2025, me një vit për zbatueshmërinë e tij.

Znj. Caca, solli në vëmendje rastet e bashkive Has, Tropojë, Patos dhe Lushnje, pasi këto bashki kishin specifike **aktin e konfirmimit nga ana e Prefektit**. Ajo bëri një sqarim, duke u mbështetur në Aneksin 3 të Udhëzimit, ku përcaktohet se vendimi i këshillit bashkiak duhet të jetë i konfirmuar nga Prefekti për të vërtetuar ligjshmërinë e tij. Në këto raste konkrete, Prefekti nuk ka dhënë një qëndrim lidhur me ligjshmërinë, pasi nuk i ka trajtuar vendimet si akte normative. Si pasojë, Prefekti është shprehur se nuk është objekt shqyrtimi nga ana e tij.

Znj. Hysa vijoi duke sqaruar se disa bashki kanë përcjellë Vendimin e Këshillit Bashkiak jashtë afatit të përcaktuar në udhëzim (1 Janar – 17 Shtator 2025), konkretisht bashkitë: Finiq, Kukës dhe Peqin. Ajo theksoi gjithashtu se janë evidentuar raste kur nuk është përcjellë akti i konfirmimit të vendimit nga Prefekti, si në rastin e Bashkisë Divjakë, si dhe raste me mungesë dokumentacioni, si në Bashkinë Memaliaj. Në përfundim, ajo bëri me dije se Bashkia Kurbin paraqet një rast specifik, pasi ka përcjellë vetëm procesverbalin e dëgjësës publike për planin.

KONKLuzionet PARAPRAKE MBI KRITERIN E PLOTËSISË

- Totali i aplikimeve → **33 bashki**
- Vendim i Këshillit Bashkiak (brenda afatit) → **29 bashki**
- Dokumenti i Planit → **29 bashki**
- Akt konfirmimi i vendimit nga Prefekti → **24 bashki**
- Procesverbali i VKB-së → **28 bashki**
- Lidhja e publikimit në faqen zyrtare → **29 bashki**

Përmbledhje tabelare e dokumentacionit të disponuar nga bashkitë

Bashkia	Dokum enti i Planit	VKB (brenda 1 janar – 17 shtator 2025)	Akti i Konfirmimit të Vendimit të Prefektit	Procesverbali	Publikimi në Faqe	5 Kriteret
Berat	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Bulqizë	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Delvinë	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Dibër	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Divjakë	✓	✓	✗	✓	✓	✗
Dropull	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Elbasan	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Finiq*	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Fushë-Arrëz	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Gramsh	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Has**	✓	✓	✗	✓	✓	✗
Himarë	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Kamëz	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Klos	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Kolonjë	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Konispol	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Kukës*	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Kurbin	✓	✓	✓	✗	✓	✗
Librazhd	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Lushnje**	✓	✓	✗	✓	✓	✗
Memaliaj	✓	✗	✗	✗	✗	✗
Malësi e Madhe	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Mat	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Patos**	✓	✓	✗	✓	✓	✗
Peqin*	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Përmet	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Pogradec	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Polican	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Prrenjas	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Pukë***	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Sarandë	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Tropojë**	✓	✓	✗	✓	✓	✗
Vorë	✓	✓	✓	✓	✓	✓

* Këto bashki rezultojnë me miratimin e Planit nga Këshilli Bashkiak jashtë afatit të përcaktuar, sipas [Udhëzimit të Përbashkët Nr.01, datë 11.07.2025](#).

** Prefekti është shprehur se Vendimi i Këshillit Bashkiak “Për miratimin e planit të integritetit” nuk është akt normativ dhe si i tillë nuk është objekt shqyrtimi i tij.

*** Bashkia Pukë ka paraqitur dokumentacion sipas udhëzimit, por ka specifikë procedurën e planit pasi ka miratimin e VKB për shtyrje afati të Planit të Integritetit 2022-2025 me një vit.

Pas prezantimit të rezultateve, z.*Erton Kashta –Btf/HELVETAS*, ngriti pyetjen, meqënëse ka një udhëzim të përbashkët nga MSHPV dhe MF, a lind një detyrim për prefektin nga udhëzimi, që të konfirmojë legjitimitetin, pavarësisht se nuk përbën një akt normativ?

Znj. Adelina Farriçi – Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë – Anëtare Komisioni sqaroi se në kuadër të ligjit të ri për Prefektin, është përcaktuar qartë se Prefekti duhet të shprehet për ligjshmërinë e akteve normative të nxjerra nga njësitë e qeverisjes vendore, përmes një akti konfirmimi.

Znj. Rovenia Pregja - Drejtor-DPAP në varësi të MAPA, theksoi se do të rikonfirmojë, për dijeni të të gjithëve, rastet që nuk plotësojnë kriteret e cilësisë dhe për rrjedhojë nuk kualifikohen.

Z. Frashëri, pyeti përfaqësuesit e ministrisë së linjës, për vlerëimet e tyre në lidhje me kriteret e cilësisë.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionit sqaruan se, për shkak të kufizimeve kohore, nuk kanë pasur mundësi fizike për të shqyrtuar në mënyrë të plotë përmbushjen e kriterëve të cilësisë.

U vijua me paraqitjen e Planit të Integritetit të Bashkive, për të vlerësuar cilësinë e planit sipas Aneksit 3. Lindën diskutime mbi përmbajtjen e planeve, duke vlerësuar ato në përmbushje ose jo të kriterëve të cilësisë sipas udhëzimit. Gjatë diskutimit *Z. Viktoria Spiro – Përgjegjës në DPAK* dhe *Znj. Pregja* evidentuan mungesën e kalendarit të përcaktuar për zbatimin e masave dhe buxhetimit të planit.

Mbyllja e Mbledhjes

Z. Frashëri, theksoi nevojën për shtyrjen e vlerësimit për ditën e hënë 20 tetor 2025, në mënyrë që të sigurohet një vlerësim i plotë nga përfaqësuesit e Ministrisë së Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionit. U ra dakord që në ditën e hënë të realizohet vlerësimi paraprak i bashkive mbi planin e Integritetit.

Anëtarë e Vlerësimit të Komisionit të Aplikimeve

Lista e anëtarëve të KVA				
Treguesi: Plani Vendor i Integritetit				
Nr.	Institucioni	Emër	Mbiemër	Pozicioni në KVA
1	MSHPV	Sonil	Frashëri	Kyetar
2	SHKBSH	Adelina	Farriçi	Anëtar
3	MF	Fran	Brahimi	Anëtar
4	MAPA	Rovenia	Pregja	Anëtar
5	MAPA	Viktoria	Spiro	Anëtar